



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2271/5 prot.

Datë 03.09.2024

V E N D I M

Nr. 1186/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.09.2024, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-15250-08-02-2024, me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT”, me fond limit 8,781,084.61 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 15.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara SHA.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK me NUIS K91413010N dhe adresë: Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga Fatmir Haxhiu, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara SHA, me adresë: Blv “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, 1001, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.08.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-15250-08-02-2024, me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT”, me fond limit 8,781,084.61 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 15.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara SHA.

II.2. Në datën 12.08.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4433, protokolluar me nr. 2271 /2024, datë 13.08.2024 e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i fondit limit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, e më konkretisht, pretendohet si më poshtë vijon:

“Fondi limit i përcaktuar për zhvillimin e kesaj procedure prokurimi, nuk është real për kushtet aktuale të tregut dhe nuk i pergjigjet realitetit. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve, nuk është përcaktuar metoda apo menyra e zgjedhur nga Autoriteti Kontraktor për përcaktimin e fondit limit të kesaj procedure, sipas parashikimeve të nenit 76 të VKM-se nr. 285/2021, e

ndryshuar. Per realizimin e ketij sherbimi jane kerkuar 10 punonjes, nga te cilet: 1 pergjegjes (me profesion inxhinier pyjesh/agrar/agronom), 8 punetore dhe 1 shofer. Per llogaritjen e pagave te ketyre punonjesve, kemi marre nje mesatare te pagave te pozicioneve te ngjashme prane shoqerise tone, si ne vijim:

Pergjegjesi: $86,500 \text{ leke} \times 1p = 86,500 \text{ leke/muaj bruto}$

Punetoret: $62,300 \text{ leke} \times 8p = 498,400 \text{ leke/muaj bruto}$

Shoferi: $117,300 \text{ leke} \times 1p = 117,300 \text{ leke/muaj bruto}$

Kosto mujore e punonjesve: $702,200 \text{ leke/muaj}$

Kosto vjetore: $702,200 \text{ leke} \times 12\text{muaj} = 8,426,400 \text{ leke}$

Kosto 2 vjetore: $702,200 \text{ leke} \times 24 \text{ muaj} = 16,852,800 \text{ leke}$

Disa prej sherbimeve (referuar Grafikut te publikuar nga vete AK), duhet te behen Ádo dite te vitit (365 dite sherbim), dhe duhet te llogariten te gjitha oret shtese per fundjavat dhe festat zyrtare. Pagat duhet te llogariten te plota pasi, kerkohet qe sherbimi te kryhet cdo dite me kohe te plote (dhe nuk eshte e mundur qe punonjesit qe jane te kontraktuar per realizimin e sherbimeve sipas kesaj kontrate, te angazhohen ne kontrata te tjera).

Nuk eshte llogaritur ketu kostoja e automjeteve dhe mjeteve te punes qe kerkohen per kryerjen e sherbimit si:

Autobot per vaditje

Krasitese ligustrash

Korrese bari

Fije motokose

Motosharre

Gershere per krasitje

Pervec automjeteve, duhet te behen edhe trajtime si psh sperkatje me insecticide, pleherim etj., kosto te cilat duhet te llogariten si shpenzime te shtuara.

Pra, duket qarte qe fondi limit i llogaritur per kete procedure, nuk eshte real, nuk i korrespondon realitetit dhe nuk nxit pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi. Fondi limit eshte nje nder elementet e rendesishme te nje procedure prokurimi, qe percaktohet qe ne nisjen e saj, ne urdhrin e prokurimit, sic percaktohet ne ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe ne baze te fondit limit behet perzgjedhja e llojit te procedures si dhe hartohen dokumentet standarde te tenderit.

Per kete arsye, kerkojme qe autoriteti kontraktor te ri-llogarise fondin limit dhe te reflektroje rritjen perkatese reale.”

II.4. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.5. Në datën 20.08.2024, është protokolluar në KPP me nr. 2271/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 1008/6 prot., datë 19.08.2024, me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” lidhur me modifikimin e dokumentave standarde të tenderit, në procedurën e prokurimit me nr.Ref-15250-08-02-2024, me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT”, bashkëlidhur Vendimi i

KSHA-së mbi ankesën e parqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK si dhe dokumentacioni mbi argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar vendimit të KSHA-së rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK dhe ka vendosur mospranimin e saj si më poshtë vijon:

“[...]Operatori Ekonomik, “PASTRIME SILVIO” SHPK ka ankimuar fondin limit të përcaktuar, duke e konsideruar jo real për kushtet aktuale të tregut dhe nuk i përgjigjet realitetit. [...] Komisioni i shqyrtimit të ankesës, pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese arsyeton:

Në DST fondi limit i parashikuar për këtë procedurë prokurimi është 8,781,084.61 (tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH. Në shtojcën 6 “Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit” është përcaktuar si më poshtë:

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Shërbim i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta për QSUNT, të përshkruara në specifikimet teknike.

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Frekuenc a ditë/për 24 muaj	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
<i>Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>23,855 m²</i>	<i>730</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Punim me bel, shkriftim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>5,000 m²</i>	<i>24</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Furnizim dhe mbjellje fare bari (50 g/m²)</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>5,000 m²</i>	<i>8</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Prashitje shkurresh dhe drurësh + plehrim kimik drurë (nitrat)</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>4,650 copë</i>	<i>28</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>1,800 ml</i>	<i>28</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Pleherim/ shperndarje me pleh organik</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>1,000 m²</i>	<i>2</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Spërkatje me insecticide</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>300 copë</i>	<i>10</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>23,855 m²</i>	<i>28</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>23,855 m²</i>	<i>300</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>

Grafiku i zërave për vitin e parë të kontratës

Nr.	Përshkrimi	jana r	shkurt	mars	prill	maj	qeshor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Totali

1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	365
2	Punim me bel, shkriftim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
3	Furnizim dhe mbjellje fare bari (50 g/m ²)			1		1	1			1				4
4	Prashitje shkurresh dhe drurësh + plehrim kimik drurë (nitrat)			2	2	2	2	2	2	2				14
5	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre			2	2	2	2	2	2	1	1			14
6	Pleherim shperndarje me pleh organik			1										1
7	Spërkatje me insecticide				1	1	1	1	1					5
8	Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre			2	2	2	2	2	2	1	1			14
9	Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot			4	5	15	30	31	31	15	15	4		150

Grafiku i zërave për vitin e dytë të kontratës

Nr.	Përshkrimi	jana r	shkur t	mars	prill	maj	qeshor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Totali
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	365
2	Punim me bel, shkriftim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
3	Furnizim dhe mbjellje fare bari (50 g/m ²)			1		1	1			1				4
4	Prashitje shkurresh dhe drurësh + plehrim kimik drurë (nitrat)			2	2	2	2	2	2	2				14
5	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre			2	2	2	2	2	2	1	1			14
6	Pleherim shperndarje me pleh organik			1										1
7	Spërkatje me insecticide				1	1	1	1	1					5
8	Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre			2	2	2	2	2	2	1	1			14
9	Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot			4	5	15	30	31	31	15	15	4		150

Nga shqyrtimi i dokumenteve të vëna në dispozicion nga njësia e prokurimit, pjesë e së cilës është dhe dokumentacioni i përcjellë nga QSUNT me shkresën nr. 75/8, datë 02.07.2024,

protokolluar në OBP me nr. 784 datë 04.07.2024, rezulton se për përlllogaritjen e fondit limit grupii punës i ngritur për këtë qëllim ka bërë studimin e tregut duke marrë oferta nga operatorët ekonomikë që operojnë në fushën objekt prokurimi, nga vlerat e të cilave ka nxjerrë mesataren e cmimit për secilin zë sipas tabelës së mësipërme.

Referuar Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe VKM-së Nr. 285/2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku është parashikuar shprehimisht se: “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të botuara”.

komisioni i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit për procedurën objekt ankese për zërat nr.1, nr.3, nr.5, nr.6, nr.7, nr.8 dhe nr.9, i është referuar kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë Autoriteti Kontraktor përfitues i shërbimit, kurse për zërat nr.2 dhe nr.4 (si zëra të modifikuar) i është referuar cmimit mesatar të ofertave të paraqitura nga studimi i tregut si më sipër. Nga sa më sipër, vlera e përlllogaritur e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra për 24 muaj”, ka rezultuar të jetë me vlerë:

- 8,767,764.61 (tetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

- 10,521,317.53 (dhjetë milione pesëqind e njëzet e një mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e tre) lekë me TVSH.

KSHA, referuar sa më sipër gjykon se përlllogaritja e fondit limit bërë nga përfituesi i shërbimit lt QSUNT është konform procedurave ligjore të parashikuar shprehimisht nga legjislacioni për Prokurimet Publike konkretisht pika 2 e nenit 34 të Ligjit “Për Prokurimet Publike”, germa b” dhe “c” e pikës 1 të neni 76 të Vendim lt nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të Këshillit të Ministrave. Për këto arsye KSHA vendosi refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 05.08.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-15250-08-02-2024, me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT”, me fond limit 8,781,084.61 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 15.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara SHA.

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është përcaktuar si më poshtë:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra duhet të ofrohet në mënyrë sa më cilësore, pasi QSUT ka në fokus cilësinë e kujdesit ndaj pacientit. Ky shërbim ka ndikim direkt jo vetëm tek përmirësimi i shëndetit të pacientit por dhe tek stafi mjekësor e jomjekësor, si dhe tek vizitorët apo qytetarët që qarkullojnë brenda territorit të QSUT. QSUT kërkon nga Subjekti që do të ofrojë këtë shërbim, si më poshtë:

- 1. Grafiku i zbatimit të shërbimit për çdo muaj, pas miratimit nga A.K. do merret nga O.E. disa ditë para fillimit të muajit pasardhës;*
- 2. Makineritë dhe mjetet, që duhen për të realizuar procesin e punës çdo ditë rutinë:
 - Të mos mungojnë në magazinat e tyre, asgjë e domosdoshme për çdo ditë pune, që nga krehërat e barit, makinat korrëse, gërshërët për krasitje, koshat e nevojshëm për mbledhjen e mbeturinave (nga kositja, korrja, krehërimi etj), fidanë për zëvendësimin e rrënjëve të reja të dëmtuara, plehëra kimik, etj.**
- 3. Pastrimi i sipërfaqeve të gjelbërta do të bëhet me krëhër bari.*
- 4. Kositja, ujitja, krasitja, mbjellja etj, do të bëhen sipas preventivit dhe sezoneve përkatëse.*
- 5. Personeli përgjegjës për zbatimin e kontratës, është i detyruar të:
 - Të zbatojë në punë orarin e caktuar.*
 - Të ketë etikë dhe komunikim gjatë procesit të punës.*
 - Të jenë bashkëpunues në rastet e nevojshme dhe të veçanta për ofrimin ekstra të këtij shërbimi.*
 - Të zbatojnë me përpikmëri zërat e preventivit, sipas planit mujor të miratuar.*
 - Punëtorët do të jenë të veshur me veshjet përkatëse identifikuese të paisur me doreza (të miratuara nga Autoriteti Kontraktor), me kartat identifikuese të personelit (të miratuara nga Autoriteti Kontraktor), si dhe do të zbatojnë rregullat e brendshme, rregulloren e monitorimit të këtij shërbimi, të vendosura nga Q.S.U.T-ja.**

6. O.E. duhet të ketë numrin e punëtorëve dhe përgjegjësit e tyre (sipas kontratës) dhe do t'i vihet lista emërore në dispozicion A.K. menjëherë me lidhjen e kontratës.

Për mirëmbajtjen ditore të sipërfaqeve të gjelbërta të territorit të QSUT-së, është e rëndësishme ndarja e këtij territori në zonat e mëposhtme, në mënyrë që mbulimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra përreth këtyre godinave që përmban cdo zone, të ketë mbulimin e duhur sipas grafikut mujor që do ti jepet O.E. nga A.K. çdo muaj. OE është i detyruar ti përgjigjet kërkesave të AK për ndarjen e punës me oraret që çdo zë i këtij shërbimi ka si protokoll të kryhet. Punëtorët do të punojnë paradite, por edhe pasdite dhe në oraret e mëngjesit herët apo vonë në darkë sidomos për zërin vaditje.

Zona e parë, përfshin sipërfaqet e gjelbërta përreth këtyre godinave: Hyrja Kryesore për në QSUT, Spitali Onkologjik përreth gjithë sipërfaqes së tij, Akselatorin Onkologjik, Godinën e Spitalit Infektiv dhe sipërfaqet përreth tij, Godina e Konsultave;

Zona e dytë, përfshin sipërfaqet e gjelbërta përreth këtyre godinave : godina e Djegie Plastikës (para dhe mbrapa saj), Klinikat Kirurgjikale (rreth klinikave nga jashtë dhe brënda), Spitalin e Ri (Urgjencat), Spitalin Nr.1 (6 katëshin) përpara dhe pjesën mbrapa, Reparti Qendror i Kaldajave, Mjekësinë Ligjore;

Zona e tretë, përfshin sipërfaqet e gjelbërta përreth këtyre godinave: Godinën e Statistikës (ish-rektorati), të dy godinat e Pediatrive.

Zona e katërt, përfshin sipërfaqet e gjelbërta përreth këtyre godinave: Drejtorinë e Përgjithshme, Depon Qëndrore të ujit, Spitalin Francez, Godinën e Kardiokirurgjisë dhe Kirurgjisë Vaskulare, rrugën mbrapa spitalit francez (rruga shameti) deri tek hyrja/dalja e pediatriisë;

Zona e pestë, përfshin sipërfaqet e gjelbërta përreth godinave të Spitalit Nr.5 (Neurologjinë, Neurokirurgjinë, Shërbimin e Psikiatriisë);

Zona e gjashtë, përfshin sipërfaqet e gjelbërta përreth Spitalit Qendror (A2), e cila është funksionale si godine nga muaji mars 2023.

O.E. është i detyruar të zbatojë me përgjegjshmëri, të gjitha pikat e preventivit sipas planit mujor të punës të miratuar, por edhe të jetë i vëmendshëm në mirëmbajtjen e këtyre sipërfaqeve.

O.E. duhet:

- Të pastrojë me krehër sipërfaqet e gjelbra, për ta mbajtur të gjelbër dhe të shëndetshëm, këtë sipërfaqe.
- Të mirëmbajë sipërfaqet e dëmtuara, nga ulja pa kriter e njerëzve dhe nga thatësitrat e periudhës së verës.
- Të ujisë me autobot, sipas sezoneve gjithë sipërfaqen e gjelbërt.
- Të mos përdorë ujin e pijshëm të QSUT-së, për ujitje.
- Të ndihmojë profesionalisht për shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta dhe ambienteve relaksuese, rreth godinave spitalore.
- Të jenë bashkëpunues, për çdo të papritur dhe tu përgjigjen kërkesave të Q.S.U.T-së.
- Të krasit gardhet e gjelbërta dhe drurët në forma bashkëkohore nga specialistë të mirëfilltë.

- Të vendosen tabela ndërgjegjësuese, në vendet e duhura për të ruajtur gjelbërimin.

Aktiviteti Ditor (A.D.)

- A.D. gjatë sezonit të verës:

1. Vaditja do të bëhet sipas grafikëve mujorë, për ruajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta, duke i'u referuar protokolleve (mëngjes herët pa lindjen e diellit dhe në darkë vonë pas perëndimit të diellit).

- A.D. gjatë sezonit të pranverës:

1. Sipërfaqet e QSUT-së të modelohen me shkurre dekorative, gardhe ligustre dhe të mirëmbahen sipas protokolleve.
2. Të përdoren modele bashkohore në zbukurimin e çdo ambient të jashtëm me miratim të AK.

- A.D. gjatë sezonit vjeshtë-dimër:

1. Bari të pastrohet me krehër më shpesh, me qenë se ndodh rënia e gjetheve nga pemët.
2. Të marren masa nga O.E. për heqjen e pemëve të infektuara, të dëmtuara dhe që paraqesin rrezik për jetën e njeriut.

- A.D. gjatë sezonit të mbjelljes:

1. Të mirëmbajë sipërfaqet e dëmtuara të barit me punime toke, plehërim dhe mbjellje.
2. Të jetë bashkëpunues dhe të kryej punime cilësore.

Kontrollet e çdo ditë do të synojnë sa më sipër, por edhe në zërat kryesorë të preventivit:

- Mirëmbajtje lulishtesh me bar natyral.
- Mirëmbajtje, ripërtëritje shkurre dekorative.
- Pastrim me krehër i mjediseve të gjelbërta.
- Prashitje shkurresh.
- Krasitje e gardheve të gjelbra.
- Kositje bari me kosë/makinë korrëse dhe largimi i mbeturinave të tyre.
- Vaditje sipërfaqe të gjelbërt (bar natyral dhe bar i kultivuar) (përveç ditëve me shi).
- Vaditje pemësh, fidanësh.
- Të bëhet prashitja e shkurreve/luleve dhe pemëve, sa herë të jetë e nevojshme.
- Rikompozimi i sipërfaqeve sipas nevojës dhe kërkesës së AK.

- *Vendosja e tabelave ndërgjegjësuere për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta dhe mbajtjen pastër, të çdo pjese jashtë godinave spitalore.*

Përshkrimi i shërbimeve:

Pastrimi me krehër bari, është një proces që duhet të kryet çdo ditë, kjo për arsye se fluksi i vizitorëve në QSUT është i madh, por edhe për faktin që (Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre), bën ajërosjen e barit dhe për rrjedhojë, rigjenerimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra, do të sjellë në çdo kohë sipërfaqe të gjelbëruar.

(Punim me bel, shkruftim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash), (Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g/m²), (Prashitje shkurresh dhe druresh+ plehrim kimik drurë (nitrat)) janë domosdoshmëri për sipërfaqet e dëmtuara duke bërë një rikompozim të tyre, por edhe çdo pemë dhe shkurre dekorative, ka nevojë për kryerjen e këtyre zërave me qëllim marrjen e ujit dhe plehërave kimike, krijon efekte relaksuese për syrin e vizitorëve dhe punonjësve. Të gjithë këta zëra, kryhen njëri mbas tjetrit, por në funksion të njëri-tjetrit dhe moskryerja e një zëri pengon zhvillimin e punës në mënyrë lineare.

Gërmimi(punimi) i tokës rreth shkurreve/pemëve, (Pleherim shperndarje me pleh organik) spërkatja e bimëve me kimikate janë procedura të rëndësishme që përfshijnë trajtimin e kopshtit për dëmtuesit dhe sëmundjet. Mbledhja me gërmime ndihmon në luftimin e dëmtuesve që jetojnë në tokë. Kjo procedurë kryhet pak para spërkatjes së kopshtit me agjentë mbrojtës.

Krasitje e gardheve të gjelbërta, Kositje bari dhe largimi i tyre, janë zëra që jo vetëm janë domosdoshmëri për higjienën e terrenit, por sjellin një imazh qetësues për syrin e çdo vizitori, apo punonjësi në QSUT.

Vaditje sipërfaqeve të gjelbra me autobot, është llogaritur të kryhet në periudhat më të nevojshme, sidomos në periudhën e verës, ku vaditja është e përditshme, si rezultat i temperaturave të larta, por edhe pranvera dhe vjeshta, referuar ndjekjes vit mbas viti të këtij shërbimi, e ka të domosdoshme vaditjen e sipërfaqeve të gjelbra disa herë në muaj.

Spërkatje me insekticide, është një zë tepër i nevojshëm për largimin e inskteve nga pemët. Ky zë kryhet në periudhën pa çelur gjethja dhe vijon deri në muajin gusht.

III.1.3. Në shtojcën 6 “Formulari i shërbimeve dhe grafiku i ekzekutimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Shërbim i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta për QSUNT, të përshkuara në specifikimet teknike.

Afatet e ekzekutimit:

<i>Shërbimet</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Shuma</i>	<i>Frekuenca ditë/për 24 muaj</i>	<i>Vendi i ekzekutimit</i>	<i>Afati i ekzekutimit</i>

<i>Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>23,855 m²</i>	<i>730</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Punim me bel, shkriftim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>5,000 m²</i>	<i>24</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Furnizim dhe mbjellje fare bari (50 g/m²)</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>5,000 m²</i>	<i>8</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Prashitje shkurresh dhe drurësh + plehrim kimik drurë (nitrat)</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>4,650 copë</i>	<i>28</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>1,800 ml</i>	<i>28</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Pleherim/ shperndarje me pleh organic</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>1,000 m²</i>	<i>2</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Spërkatje me insecticide</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>300 copë</i>	<i>10</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>23,855 m²</i>	<i>28</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>
<i>Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot</i>	<i>Sipas specifikimeve teknike</i>	<i>23,855 m²</i>	<i>300</i>	<i>Në ambientet e QSUNT</i>	<i>24 muaj nga nënshkrimi i MK</i>

Grafiku i zërave për vitin e parë të kontratës

Nr.	Përshkrimi	<i>jana</i>	<i>shkurt</i>	<i>mars</i>	<i>prill</i>	<i>maj</i>	<i>qeshor</i>	<i>korrik</i>	<i>gusht</i>	<i>shtator</i>	<i>tetor</i>	<i>nëntor</i>	<i>dhjetor</i>	Totali
1	<i>Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre</i>	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	365
2	<i>Punim me bel, shkriftim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash</i>	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
3	<i>Furnizim dhe mbjellje fare bari (50 g/m²)</i>			1		1	1			1				4
4	<i>Prashitje shkurresh dhe drurësh + plehrim kimik drurë (nitrat)</i>				2	2	2	2	2	2				14
5	<i>Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre</i>				2	2	2	2	2	1	1			14
6	<i>Pleherim shperndarje me pleh organic</i>				1									1
7	<i>Spërkatje me insecticide</i>				1	1	1	1	1					5
8	<i>Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre</i>				2	2	2	2	2	1	1			14
9	<i>Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot</i>				4	5	15	30	31	31	15	15	4	150

Grafiku i zërave për vitin e dytë të kontratës

Nr.	Përshkrimi	jana r	shkur t	mars	prill	maj	qeshor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Totali
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	365
2	Punim me bel, shkrifim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
3	Furnizim dhe mbjellje fare bari (50 g/m ²)			1		1	1			1				4
4	Prashitje shkurresh dhe drurësh + plehrim kimik drurë (nitrat)			2	2	2	2	2	2	2				14
5	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre			2	2	2	2	2	2	1	1			14
6	Pleherim shperndarje me pleh organic			1										1
7	Spërkatje me insecticide				1	1	1	1	1					5
8	Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre			2	2	2	2	2	2	1	1			14
9	Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot			4	5	15	30	31	31	15	15	4		150

Grafikët e mësipërm, shpërndarja e zërave mund të ndryshojë vetëm me kërkesë të sektorit që ndjek kontratën/at.

III.1.4. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, parashikohet shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në

mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6. Neni 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit” 3. Autoriteti ose enti kontraktor në fazën e hartimit të nevojave të tyre për mallra, punë, shërbime mbajnë në konsideratë metodat e përlllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përlllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale përpara dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.

III.1.7. Neni 1 i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike të përcaktuara për përdorim në prokurimet publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik” (në vijim, LPP), të këtyre rregullave, dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim, APP), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP-së.

2. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të planifikojë në cilësi dhe në kohë nevojat e tij e fondet publike respektive dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.8. Neni 13 “Studimi paraprak i tregut”, i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon shprehimisht se:

Përpara se të nisë një procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor mund të studiojë tregun, me qëllim që të përgatisë prokurimin, të përditësojë të dhënat që ka përdorur për hartimin e buxhetit dhe regjistrave të parashikimit, si dhe të informojë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim.

2. Studimi i tregut ka për qëllim përlllogaritjen e një vlere reale të kontratës dhe të shmangë dështimin e procedurës për vlera që nuk përputhen me vlerat reale të tregut.

3. Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit ngarkon me detyrë për studimin e tregut, një ose disa persona, që mund të jenë një grup pune i ngritur për këtë qëllim çdo fillim viti, ose rast pas rasti.

4. Për studimin e tregut, autoriteti/enti kontraktor, mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg me shkrim ose verbalisht. Në rastin e konsultimit verbalisht, grupi i ngritur për këtë qëllim, harton një procesverbal me këto të dhëna. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në 15 shtrembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës

III.1.9. Neni 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:
 - a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
 - b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
 - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
 - ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.
2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.
3. Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

III.1.10. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se fondi limit është një ndër elementet e rëndësishme të një procedure prokurimi, që përcaktohet që në nisjen e saj, në urdhrin e prokurimit, siç përcaktohet në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe në bazë të fondit limit bëhet përzgjedhja e llojit të procedurës si dhe hartohen dokumentet standarde të tenderit. Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, e pagueshme, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara dërgimit për botim, të njoftimit të procedurës së prokurimit. Për përllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit janë përcaktuar mënyrat konkrete, të cilat gjejnë rregullim në nenin 76 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në dispozitën e sipërcituar parashikohet shprehimisht, se në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave si vijon: a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe c) çmimet e kontratave të mëparshme,

të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht. Në rastin konkret, referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në përlllogaritjen e fondit limit, ky i fundit është bazuar në kontratat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit përsa i përket zërave 1,3,5,6,7,8 dhe 9 të realizuara nga vetë autoriteti kontraktor përfitues i shërbimit. Konkretisht për këto zëra, referuar shkresës me nr. 75 prot., datë 05.01.2024 me objekt: “Argumentimi i forndit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe argumentimin e nevojave për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim gjelbërimi për QSU “Nënë Tereza” për 24 muaj”, pjesë e informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur në KPP nga AK, rezulton se komisioni i ngritur me urdhërin e brendshëm nr. 745, datë 06.12.2023 për përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e mësipërme të prokurimit i është referuar Marrëveshjes Kuadër me nr. 102/6 prot., datë 23.02.2022, administruar në protokollin e QSUT-së me nr. 371/3 prot., datë 25.02.2022, ndërkohë konstatohet se në materialet e depozituara në Komisionin e Prokurimit Publik, rezulton se AK nuk ka paraqitur këtë kontratë, por ka paraqitur kontratën e shërbimit me nr. 356/23 prot., datë 29.12.2023 me katër zëra shërbimi dhe konkretisht me zërat;

- Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbëra.
- Punim me bel
 - Nivelim mbledhje mbeturinash dhe largimi i tyre.
 - Shkriftim dhe thyerja plisash

Zërat e tjera të kontratës janë me vlerën “0”, pavarësisht cmimit të ofruar në të. Në këto kushte AK nuk mund ti përdorë këto zëra si referencë të eksperiencave të mëparshme, në kuptim në ligjit të prokurimit publik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për më tepër që konstatohet mospërputhje midis deklaratimit të bërë nga komisioni i ngritur me urdhërin e brendshëm nr. 745, datë 06.12.2023 për përlllogaritjen e fondit limit dhe kontratës të depozituar në KPP si më sipër cituar, bashkëngjitur shkresës nr. 1008/6, datë 19.08.2024.

Gjithashu rezulton se autoriteti kontraktor ka siguruar oferta nga tre subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e objektit të prokurimit. Nga shqyrtimi i tyre rezulton se ofertat e paraqitura janë më të larta se fondi limit i procedurës objekt ankimimi.

III.1.11. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për përcaktimin e nevojave të tij për mallra, shërbime e pune, duke përcaktuar për secilën prej tyre sasi të përkatëse dhe të duhura sipas nevojave të tij dhe specifikimet teknike të tyre, duke përcaktuar edhe fondin limit për një objekt të caktuar prokurimi. Pra, është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, si organi me interes të drejtëpërdrejtë për kryerjen e procedurës së prokurimit, si edhe organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike, të përcaktojë fondin limit të procedurës së prokurimit, në përputhje me natyrën e mallrave dhe shërbimeve, si dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe termave të referencës, në zbatim të neneve 13 dhe 76 të rregullave të prokurimit publik si më sipër cituar. Por në rastin konkret Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se fondi limit i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nuk është argumentuar për kryerjen e shërbimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet. Fondi limit është një ndër elementet

e rëndësishme të një procedure prokurimi, që përcaktohet që në nisjen e saj, në urdhrin e prokurimit, siç përcaktohet në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe në bazë të fondit limit bëhet përzgjedhja e llojit të procedurës si dhe hartohen dokumentet standarde të tenderit. Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, e pagueshme, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara dërgimit për botim, të njoftimit të procedurës së prokurimit. Për përlllogaritjen e fondit limit të pocedurës së prokurimit janë përcaktuar mënyrat konkrete, të cilat gjejnë rregullim në nenin 76 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”. Në dispozitën e sipërcituar parashikohet shprehimisht, se në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave si vijon: a) *çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për përcaktimin e nevojave të tij për mallra, shërbime e pune, duke përcaktuar për secilën prej tyre sasi të përkatëse dhe të duhura sipas nevojave të tij dhe specifikimet teknike të tyre, duke përcaktuar edhe fondin limit për një objekt të caktuar prokurimi. Pra, është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, si organi me interes të drejtëpërdrejtë për kryerjen e procedurës së prokurimit, si edhe organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike, të përcaktojë fondin limit të procedurës së prokurimit, në përputhje me natyrën e mallrave dhe shërbimeve, si dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe termat e referencës, në zbatim të neneve 13 dhe 76 të rregullave të prokurimit publik si më sipër cituar.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...] gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt - ankimi dhe në rishpallje të saj të këtë parasysht konstatimet në vendim.*

Pretendimet e ankimesit qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-15250-08-02-2024, me objekt: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT”, me fond limit 8,781,084.61 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 15.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara SHA.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro